



**Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

### **MEKANIKË**

**Niveli IV në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit IV të KEK<sup>2</sup>**

**F-IV-19**

Tiranë, Shtator 2019

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	MEKANIKË			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	IV KSHK, referuar nivelit IV të KEK	F-IV-19
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “ <b>Mekanikë</b> ”, <b>niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK</b> , është të përgatisë specialistë të nivelit teknik/menaxher në fushën e mekanikës dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë e menaxhimit të një reparti, sektori, linje prodhimi, brigade ose njësie të ngjashme të kësaj fushe apo për krijimin e menaxhimit të një biznesi privat, person fizik ose juridik.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në shkollat që ofrojnë arsim profesional kualifikimin profesional “<b>Mekanikë</b>”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kanë mbaruar arsimin profesional në një nga kualifikimet profesionale të nivelin III të KSHK, referuar nivelit III të KEK, drejtimin mësimor “Mekanikë”</li> <li>- janë në gjendje shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.</li> <li>- pranohen edhe individë që <u>kanë aftësi ndryshe</u>, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin</li> </ul>			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “<b>MEKANIKË</b>”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të këtij niveli që përkon me nivelin profesional <b>teknik/menaxher</b> në këtë fushë profesionale, të njohur në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ndërmarrje të ndryshme private/shtetërore që ushtrojnë aktivitet në drejtimin mekanik si teknik i mesëm. Gjithashtu, individit mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e mekanikës, në profesionet saldator, llamarinist, në fonderitë e metaleve me ngjyra, të çeliqueve etj. Po ashtu, në varësi të profilit mekanik të përfunduar në nivelin e III-të, në KSHK, referuar nivelit III të KEK, ai mund të punësohet në një biznes që operon në fushën e ndërtim-montimit, në sektorët e remontit e të mirëmbajtjes, në linjat e prodhimit të detaleve e nyjeve mekanike, në sektorët e projektimit të detaleve e nyjeve mekanike (në detyra përpunuese e ndihmëse), të prodhimit apo mirëmbajtjes së tyre, në njësi të shitjes së materialeve apo pajisjeve mekanike etj.</p> <p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional në drejtimin “Mekanik”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individit fiton të drejtën për Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale. Me përfundimin e këtij niveli, individit ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	F-III-15			

# STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

## Rezultatet e të nxënit në:

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Mekanikë” niveli IV-të në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

## NJOHURI PROFESIONALE

### Sipërmarrje dhe edukim karriere

- Të shpjegojë rolin dhe rëndësinë e sipërmarrjes së biznesit (sociale dhe ekonomike) në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme;
- Të shpjegojë kuptimin filozofik të kompanisë dhe misionin e saj në tregun e biznesit.
- Të përshkruajë fazat e zhvillimit të biznesit në kontekstin e globalizimit;
- Të analizojë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
- Të shpjegojë konceptet financiare (dokumentet financiare, institucionet financiare..);
- Të listojë komponentët e hartimit të një buxheti;
- Të përshkruajë fazat e menaxhimit të një projekti (duke identifikuar burimet e nevojshme për një projekt të veçantë);
- Të ilustrojë metoda të zgjidhjes së problemeve në kontekste të ndryshme;
- Të evidentojë mundësitë që ofron tregu i punës dhe kualifikimet e mëtejshme;
- Të përshkruajë konceptin e ndërmarrjeve me përgjegjësi sociale në kontekste lokale dhe globale;
- Të analizojë interesat, zotësitë dhe aftësitë personale përmes mënyrave të ndryshme përfshirë vetëvlerësimin.
- Të shpjegojë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit;
- Të shpjegojë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit), duke u përqendruar në mënyrën e drejtimit, integritetit, motivimit dhe mbikëqyrjes së tyre;
- Të listojë mjetet e nevojshme për sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit, për të realizuar vendim-marrje në biznes;
- Të shpjegojë dobinë e marketingut në biznes;
- Të listojë kuadrin ligjor dhe detyrimet administrative në fushën e biznesit përkatës, si pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes së tij;

### Menaxhimi financiar

- Të përshkruajë elementët e përcaktimit të kostos së prodhimit të një produkti të caktuar, metodikën e përlllogaritjes së kostos dhe rrugët për uljen e saj;
- Të dallojë ndryshimin ndërmjet shpenzimeve direkte dhe indirekte në prodhimin e një produkti të caktuar, të cilat janë pjesë e kostos;
- Të përshkruajë elementët e përcaktimit të çmimit të një produkti dhe rëndësinë e tyre;
- Të përshkruajë procedurën e procesit të normimit të një produkti përkatës si dhe elementët përbërës të saj;
- Të përshkruajë procedurën e kryerjes së preventivit të një produkti;
- Të përshkruajë përlllogaritjen e kohës kryesore dhe ndihmëse për prodhimin e një produkti;
- Të përshkruajë procedurën e administrimit të vlerave monetare, dokumentacionin përkatës për administrimin e tyre, veprimet me arkën, shitjet dhe blerjet e ndryshme që realizon ndërmarrja, si dhe veprimet me bankën;

- Të përshkruajë procedurën e administrimit të vlerave materiale, dokumentacionin përkatës për administrimin e tyre, regjistrat e magazinimit, fletë hyrjet dhe fletë daljet, regjistrin e inventarëve etj.

### **Menaxhimi i burimeve njerëzore**

- Të përshkruajë rëndësinë dhe rolin e burimeve njerëzore në suksesin e një biznesi;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe procesin e planifikimit të nevojave për burime njerëzore, arsyet e domosdoshmërisë së planifikimit të BNJ;
- Të përshkruajë rolin dhe rëndësinë e procesit të rekrutimit të BNJ dhe aktivitetet paraprake që kryhen për këtë proces;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe rolin e procesit të ngritjes profesionale të punonjësve si një faktorë në suksesin e një biznesi;
- Të përshkruajë rolin dhe rëndësinë e vlerësimit të performancës së punonjësve të një biznesi, si dhe qëllimet e saj;

### **Organizimi i punës**

- Të përshkruajë rolin dhe rëndësinë e organizimit të punës, si një element mjaft i rëndësishëm i menaxhimit të biznesit;
- Të shpjegojë mënyrën e organizimit të punës për drejtimin/menaxhimin e njësive të prodhimeve/shërbimeve mekanike si, ndërmarrje, reparte, linja prodhimi, brigadë etj.;
- Të përshkruajë rëndësinë e objektivave të organizimit të punës si p.sh.( objektivat e natyrës ekonomike, sociale, etj.);
- Të përshkruajë rolin dhe rëndësinë e strukturës organizative si një nga elementët i rëndësishëm i organizimit të punës (ndarja e punës);
- Të listojë faktorët që ndikojnë në organizimin e punës dhe ndikimin e tyre në suksesin e ndërmarrjes;
- Të argumentojë rolin dhe rëndësinë e faktorit teknik në cilësinë e organizimit të punës. (komponenti teknik : materialet, aparatet, fazat e operacioneve, vendosja fizike, caktimi i kohës, mirëmbajtja, furnizimi etj.);
- Të argumentojë rolin dhe rëndësinë e faktorit social në cilësinë e organizimit të punës: aftësitë, nevojat sociale, nevojat psikologjike, marrëdhëniet, mundësitë e të mësuarit, komunikimi, punë me variacion etj.;
- Të listojë indikatorët e kushteve të punës, si një element shumë i rëndësishëm i organizimit të punës, rëndësinë e tyre në rritjen e rendimentit dhe suksesin e ndërmarrjes;
- Të përshkruajë organizimin e vogël të punës, rëndësinë e tij dhe ndikimi i tij në tërësinë e organizimit të ndërmarrjes;
- Të listojë llojet e dokumentacionit përkatës në funksion të organizimit të punës (urdhër pune, proces verbale të fillimit dhe mbarimit të punës etj.);
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit dhe interpretimit të një urdhri pune, kartat teknologjike të thjeshta të prodhimit/shërbimit, të kontrollit teknik operacional dhe atij përfundimtar;

### **Legjislacioni i punës, mbrojtja e shëndetit dhe sigurimi i jetës në punë**

- Të analizojë aspektet ligjore të sipërmarrjeve në fushën e mekanikës;
- Të listojë disa standarde ndërkombëtare që veprojnë në fushën e legjislacionit të punës në sektorin e mekanikës;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të punës, lidhur me të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit

dhe të punëmarrësit;

- Të shpjegojë çfarë është siguria dhe shëndeti në punë, roli i tyre në suksesin e një biznesi;
- Të shpjegojë legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë të punonjësve, si dhe dispozitat e kodit të punës për mbrojtjen SSHP, detyrimet dhe përgjegjësitë e punëdhënësve për sigurimin e tij;
- Të përshkruajë faktorët që ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve dhe masat që merren për evitimin e tyre;
- Të përshkruajë shkaqet e aksidenteve në punë dhe masat që duhet të merren për evitimin e tyre;
- Të përshkruajë raste të aksidenteve që mund të ndodhin në ndërmarrjet mekanike dhe masat që merren për parandalimin e tyre;
- Të përshkruajë dokumentacionin përkatës që mbahet në lidhje me SSHP, si dhe instruktimin e punonjësve mbi zbatimin e rregulloreve dhe udhëzimeve të mbrojtjes së SSHP;
- Të përshkruajë veprimet e nevojshme që duhen kryer për të dhënë ndihmën e parë për të dëmtuarin në punë.

### **Mbrojtja e mjedisit**

- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar, që përfshinë aspektet teknike, lejet, shkallët e përgjegjësisë, dokumentacionin e detyrueshëm, raportimet periodike, etj. të mbrojtjes së mjedisit në punë;
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- Të përshkruajë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore;
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së mjedisit nga; shkarkimet e gazrave të dëmshëm në ajër, shkarkimet e lëngjeve e të ujërave të ndotur (infektuar) në mjedise të hapura, të lëndëve të ngurta jo miqësore me mjedisin, etj.;
- Të përshkruajë masat që duhen marrë dhe pajisjet e nevojshme për të bërë neutralizimin e efekteve të dëmshme të gazrave, të ujërave të ndotur dhe të mbetjeve të ngurta që janë jo miqësore me mjedisin;

### **Programet kompjuterike në mekanikë**

- Të përshkruajë programet kompjuterike (exel dhe word) për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për administrimin e ndërmarrjes;
- Të shpjegojë programet kompjuterike të përgatitjes së dokumentacionit teknik ( vizatimet teknike);
- Të shpjegojë komandat e përpunimit të vizatimeve tekinke me të gjitha elementët e tij;
- Të shpjegojë mënyrën e realizimit të detaleve dhe nyjeve të thjeshta me anën e programit “Autocad”;
- Të shpjegojë mënyrën e nxjerrjes së fletës së vizatimit në print.

### **Projektimi i procesit teknologjik të prodhimit të detaleve**

- Të përshkruajë veçoritë e procesit të prodhimit dhe procesit teknologjik;
- Të përshkruajë veçoritë e analizës konstruktive dhe teknologjike të detalit;
- Të shpjegojë faktorët që ndikojnë në përzgjedhjen e mënyrës së përgatitjes së gjysmë fabrikatit;
- Të shpjegojë rëndësinë e bazave konstruktive, vendosëse dhe ndihmëse, ndikimin dhe përcaktimin e tyre;
- Të përshkruajë hartimin e procesit teknologjik të një boshti të shkallëzuar;

- Të shpjegojë plan vendosjet e reparteve të përgatitjes së produkteve dhe sektorëve të tjerë ndihmës në lidhje me procesin teknologjik të prodhimit.

### **Llogaritja konstruktive e mekanizmave të thjeshtë**

- Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionimin e një mekanizmi të thjeshtë ( transmision me rrota cilindrike me dhëmbë të drejtë, transmision me rripa etj.);
- Të shpjegojë ndërtimin e skemave llogaritëse;
- Të shpjegojë llojet e shformimeve që i ndodhin elementëve të këtij mekanizmi;
- Të shpjegojë llogaritjet që duhet të bëhen për mekanizmin për të pasur një qëndrueshmëri të sigurt gjatë punës së mekanizmit;
- Të listojë llojet e konsumimit të detaleve dhe defekteve që pësojnë ato;
- Të listojë mënyrat e diagnostikimit të detaleve të një mekanizmi;

## **SHPREHI PROFESIONALE**

### **Sipërmarrje dhe edukim karriere**

- Të demonstrojë aftësi për të zhvilluar një projekt ide sipërmarrëse (për të zhvilluar dhe zbatuar një buxhet të caktuar).
- Të përdorë metoda dhe teknika të ndryshme të zbatimit të një projekti.
- Të analizojë të dhëna për të marrë vendimet e duhura në kontekste të ndryshme.
- Të identifikojë dhe të zgjidhë probleme në mënyrë krijuese.
- Të negociojë ide me të tjerët në mënyrë efektive.
- Të demonstrojë aftësi për të njohur dhe vlerësuar risqet.
- Të demonstrojë aftësi për të planifikuar, zbatuar, kontrolluar dhe vepruar me qëllim për t'u vetë-përmirësuar.
- Të vlerësojë potencialin personal (aftësitë personale, sociale dhe për biznes, njohuritë e mëparshme..) për të shfrytëzuar avantazhin konkurrues.
- Të demonstrojë aftësi drejtuese në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të aplikuar parimet e ekonomisë së lirë të tregut në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të motivuar dhe inkurajuar të tjerët në arritjen e synimeve të tyre;
- Të aplikojë aftësitë për planifikim dhe menaxhim projekti në situata të ndryshme;
- Të sigurojë burime e duhura dhe të marrë përgjegjësinë për t'u kujdesuar për to;
- Të menaxhojë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës;
- Të hartojë një plan efektiv biznesi në fushën e prodhimeve/shërbimeve mekanike, për krijimin e një biznesi të ri (ose për modifikim, shtesë, rinovimi, të një biznes ekzistues), për njësi të vogla prodhimi/shërbimi, për linja apo reparte prodhimi, duke u bazuar në procedura standarde;
- Të kryejë detyra tekniko-menaxheriale, nën mbikëqyrje të inxhinierëve, për realizimin e një plan biznesi, sipas planeve e programeve të hartuara nga menaxheret e nivelit më të lartë ose të një stafi menaxherial.

### **Menaxhimi financiar**

- Të llogarisë koston e prodhimit të një produkti të caktuar dhe rrugët për uljen saj;
- Të llogarisë shpenzimet direkte dhe indirekte në prodhimin e një produkti të caktuar;

- Të llogarisë çmimin e një produkti të caktuar;
- Të kryejë normimin për një produkt të caktuar;
- Të kryejë preventivin e një produkti të caktuar;
- Të llogarisë kohën kryesore për prodhimin e një produkti;
- Të përcaktojë kohët ndihmëse për realizimin e një produkti;
- Të zbatojë me rigorozitet procedurën e administrimit të vlerave monetare, mbajtjen e dokumentacionit përkatës për administrimin e tyre, veprimet me arkën, shitjet dhe blerjet e ndryshme që realizon ndërmarrja, si dhe veprimet me bankën;
- Të zbatojë me rigorozitet procedurën e administrimit të vlerave materiale, mbajtjen e dokumentacionit përkatës për administrimin e tyre, regjistrat e magazinimit, fletë hyrjet dhe fletë daljet, regjistrin e inventarëve etj.;

### **Menaxhimi i burimeve njerëzore**

- Të identifikojë nevojat e biznesit për burime njerëzore për realizimin e prodhimit;
- Të përcaktojë kriteret për planifikimin e burimeve njerëzore;
- Të përcaktojë kriteret e rekrutimit të burimeve njerëzore;
- Të identifikojë nevojat e ngritjes profesionale të punonjësve për realizimin dhe zhvillimin e prodhimit;
- Të hartojë planin e zhvillimit dhe ngritjes profesionale të punonjësve;
- Të përcaktojë kriteret e vlerësimit të performancës së punonjësve;
- Të vlerësojë performancën e punonjësve;

### **Organizimi i punës**

- Të përcaktojë objektivat e organizimit të punës si p.sh.( objektivat e natyrës ekonomike, sociale, etj.);
- Të përcaktojë strukturën organizative të një reparti mekanik;
- Të përcaktojë faktorët që ndikojnë në organizimin e punës dhe ndikimin e tyre në suksesin e ndërmarrjes;
- Të analizojë faktorët teknik në cilësinë e organizimit të punës. ( komponenti teknik : materialet, aparatet, fazat e operacioneve, vendosja fizike, caktimi i kohës, mirëmbajtja, furnizimi etj.);
- Të analizojë faktorët social në cilësinë e organizimit të punës aftësitë, nevojat sociale, nevojat psikologjike, marrëdhëniet, mundësitë e të mësuarit, komunikimi, punë me variacion etj.;
- Të interpretojë rëndësinë dhe rolin e trajtimit human si një mjet i fuqishëm në motivimin e punonjësve dhe rritjen e kënaqësisë në punë;
- Të përcaktojë indikatorët e kushteve të punës, si një element shumë i rëndësishëm i organizimit të punës, në rritjen e rendimentit dhe suksesin e ndërmarrjes;
- Të përcaktojë kriteret dhe rregullat e organizimit të vogël të punës( në një post pune);
- Të përgatisë dokumentacionin përkatës për organizimin e punës( urdhër pune, proces verbale të fillimit dhe mbarimit të punës etj.);

### **Mbrojtja e shëndetit dhe sigurimi i jetës në punë**

- Të hartojë rregullore dhe udhëzime për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, në mbështetje të legjislacionit shqiptar dhe kodit të punës;
- Të krijojë këndin përkatës të legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë të punonjësve, si dhe dispozitat e kodit të punës për mbrojtjen SSHP, detyrimet dhe përgjegjësitë e punëdhënësve për sigurimin e SSHP;

- Të evidentojë faktorët që ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve dhe masat që merren për evitimin e tyre;
- Të evidentojë shkaqet e aksidenteve në punë dhe masat që duhet të merren për evitimin e tyre;
- Të përcaktojë masat për parandalimin e aksidenteve që mund të ndodhin në repartet mekanike;
- Të hartojë dokumentacionin përkatës që mbahet në lidhje me SSHP, si dhe instruktimin e punonjësve;
- Të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe SSHP;
- Të përcaktojë veprimet e nevojshme që duhen kryer për të dhënë ndihmën së parë për të dëmtuarin në punë.

### **Legjislacioni i punës dhe mbrojtja e mjedisit**

- Të krijojë këndin përkatës të legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e mjedisit, detyrimet e biznesit për mbrojtjen e mjedisit;
- Të përcaktojë rreziqet kryesore të ndotjes së mjedisit nga: shkarkimet e gazrave të dëmshëm në ajër, shkarkimet e lëngjeve e të ujërave të ndotur (infektuar) në mjedise të hapura, të lëndëve të ngurta jo miqësore me mjedisin etj.;
- Të përcaktojë masat që duhen marrë dhe pajisjet e nevojshme për të bërë neutralizimin e efekteve të dëmshme të gazrave, të ujërave të ndotur dhe të mbetjeve të ngurta që janë jo miqësore me mjedisin;
- Të përgatisë rregulloret dhe dokumentacionin përkatës për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit.

### **Programet kompjuterike në mekanikë**

- Të përdorë programet kompjuterike (exel dhe word) për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për administrimin e ndërmarrjes;
- Të përdorë programet kompjuterike të përgatitjes së dokumentacionit teknik (vizatimet teknike);
- Të vizatojë detale të vështirësisë mesatare dhe nyje të thjeshta më anë të programit AutoCad;
- Të zbërthejë vizatimin e nyjeve të thjeshta në detale;

### **Projektimi i procesit teknologjik të prodhimit të detaleve**

- Të përcaktojë veçoritë e procesit të prodhimit dhe procesit teknologjik;
- Të përcaktojë faktorët që ndikojnë në përzgjedhjen e mënyrës së përgatitjes së gjysmë fabrikatit;
- Të kryejë analizën konstruktive dhe teknologjike të detalit;
- Të interpretojë rëndësinë e bazave konstruktive, vendosëse dhe ndihmëse, ndikimin dhe përcaktimin e tyre;
- Të kryejë hartimin e procesit teknologjik të një boshti të shkallëzuar;
- Të përcaktojë plan vendosjet e reparteve të përgatitjes së produkteve dhe sektorëve të tjerë ndihmës në varësi të procesit teknologjik të prodhimit.

### **Llogaritja konstruktive e mekanizmave të thjeshtë**

- Të analizojë ndërtimin dhe funksionimin e një mekanizmi të thjeshtë (transmision me rrota cilindrike me dhëmbë të drejtë, transmision me rripa, etj.);
- Të kryejë ndërtimin e skemës llogaritëse të një mekanizmi;
- Të përcaktojë shformimet e elementëve të këtij mekanizmi;
- Të kryejë llogaritjet për elementët përbërës të mekanizmit, duke përcaktuar përmasat dhe materialin e duhur për prodhimin e tyre;



- Të përcaktojë konsumimin e detaleve dhe defekteve që pësojnë ato;
- Të kryejë diagnostikimin detaleve të një mekanizmi, dhe të përcaktojë mënyrën e riparimit.

## **KOMPETENCA TE PËRGJITHSHME**

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme kulturore, sociale, ligjore, organizative e tekniko-profesionale.
  - Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional dhe t'i shpërndajë ato, në dobi të kolegeve e punonjësve në njësisë e tij/saj prodhuese.
  - Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
  - Të ndër marrë apo hedhë vazhdimisht ide te reja, duke hartuar projekte të reja, struktura të reja organizative, të cilat sjelli në përmirësimin e strukturave ekzistuese.
  - Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
  - Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
  - Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj.
  - Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj.
  - Të demonstrojë maturi me eproret, vartësit, partneret, etj.
  - Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
  - Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
  - Të vlerësojë dhe vetë vlerësojë aftësitë e tij/saj, nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj.
  - Të jetë i hapur dhe të veprojë si një ndër lidhës midis njësisë së tij prodhuese dhe njësive të tjera brenda ndërmarrjes apo ndërmjet ndërmarrjes dhe të tretëve jashtë saj, si furnitorët, klientët, partneret, etj., duke ndihmuar në realizimin e qëllimeve të njësisë prodhuese.
  - Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar.
  - Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe.
  - Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet.
  - Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës proaktiv në grup.
  - Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike.
  - Të pranojë dhe të promovojë rritje dhe ndryshimet.
  - Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide.
  - Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj.
- Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.